



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.191/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik, Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV)), me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.191/2025 datë 11.10.2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, në Zgjedhjet Lokale 2025 të datës 12 Tetor 2025 i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 30,000.00€uro (Tridhjetëmijë €uro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se më datë 10.10.2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë vërejtur në platformën Youtube, se Zlatan Elek dhe Novak Zivic, kryetar, përkatësisht kandidat për kryetar të Komunës së Graçanicës nga subjekti politik Lista Serbe, gjatë tubimit të mbajtur në Graçanicë janë shërbyer me termin provokativ "Kosovo i Metohija" kur i janë referuar Republikës së Kosovës.

Ky term përbën formulim politik të përdorur për të mohuar subjektivitetin shtetëror të Republikës së Kosovës dhe bie ndesh me nenin 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që përcakton se "Republika e Kosovës është shtet sovran, i pavarur, demokratik, unik dhe i pandashëm".

Përdorimi i qëllimshëm i një emërtimi që bie ndesh me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës përbën shkelje të parimit të respektit për sundimin e ligjit dhe të institucioneve të shtetit. Subjektet politike obligohen ta zhvillojnë fushatën në frymë të respektit ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës dhe rendit demokratik.

Materiali në fjalë përmban gjuhë fyese dhe nxitëse, sepse ai ka përmbajtje që cenon integritetin dhe sovranitetin e shtetit, tregon mungesë respekti dhe njollosë viktimat e luftës dhe represionit serb në Kosovë, prandaj edhe bie ndesh me frymën e nenit 34, paragrafi 1, pika 11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, fjalimet në fjalë, të shpërndara publikisht nga Lista Serbe, përbëjnë shkelje materiale të legjislacionit zgjedhor, duke promovuar një emërtim që bie ndesh me aktin më të lartë juridik të shtetit.

Prova: Fjalimi i Zlatan Elek: [http : www.youtube.com watch? =Xow4cGN M](http://www.youtube.com/watch?Xow4cGNM) Fjalimi i Novak Zivic: <https://www.youtube.com/watch?v=q2-mwVjWwGw>.

PZAP-i, më datë 11.10.2025, i dërgoi kërkesë për përgjigje në ankesën, mirëpo subjekti politik Lista Serbe, deri në afatin e paraparë më datë 12.10.2025, në ora 12:00 nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Prandaj, Paneli vëren se gjuha e përdorur në tubimin e mbajtur në Komunën e Graçanicës gjatë fushatës zgjedhore, i cili tubim është publikuar në kanalin e mediumit Kosovo online në platformën Youtube, dhe atë fjalimi nga kandidati për Kryetar për Komunën e Graçanicës nga Subjekti Politik Lista Serbe Novak Zivic i cili në këtë tubim ndër të tjera thotë se “ *...Por përgjegjësi, luftë institucionale për nder, për dinjitet, për përparim dhe zhvillim për të gjithë ne në Kosovë dhe Metohi...* ”, dhe fjalimi i Zlatan Elek, kryetar i Listes Serbe, i cili në minutën 2:02, në të njëjtin tubim të mbajtur në Komunën e Graçanicës ndër të tjera thotë se “ *...Graçanica është zemër serbe që rrah për të gjithë ne në Kosovë dhe Metohi* ” është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike përkatësisht, neni 34 paragrafi 1, pika 1.11, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 1.1, 1.2, dhe nenin 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës prandaj, për panelin një veprim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara,

Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin janë dhënë deklaratat gjatë tubimit të mbajtur në Komunën e Graçanicës, i cili tubim është publikuar në kanalin e mediumit Kosovo online në platformën Youtube, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë nga fjalimi i Novak Ziviq, kandidat për Kryetar për Komunën e Graçanicës nga Subjekti politik Lista Serbe, dhe fjalimi i Zlatan Elek kryetar i Listës Serbe, ka për qëllim nxitje të urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore. Sipas vlerësimit të Panelit, rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike, dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Kryetari i subjektit Politik Lista Serbe, Zlatan Elek, dhe nga kandidati për Kryetar për Komunën e Graçanicës nga Subjekti Politik

Lista Serbe Novak Zivic, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Paneli vlerëson se deklaratat e tilla në kontekstin zgjedhor dhe të ndjeshmërisë etnike në Republikën e Kosovës, mund të ndikojë negativisht, dhe shprehjet që janë përdorur krijojnë një atmosferë të pasigurt, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektit ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje.

Në nenin 1 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decitive thuhet se :
“Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm”.

Në nenin 1 par.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decitive thuhet “*Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj*”.

Ndërsa në nenin 2 par.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decitive thuhet *“Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.”.*

Në bazë të kësaj çdo fjalë, e përdorur në fushata zgjedhore si p.sh Kosovë dhe Metohi është në kundërshtim me neni 1.1, 1.2, dhe 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë për bazë natyrën e shkeljes dhe ndikimit të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik Lista Serbe në zgjedhjet e mëparshme, që konsiston në faktik se Lista Serbe, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë Subjekti politik Lista Serbe në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu si rrethanë që ka ndikuar në lartësinë e gjobës, paneli mori për bazë edhe rrethanën se Subjekti Politik Lista Serbe për shkelje të natyrës të njëjta është gjobitur në zgjedhjet e kaluara të mbajtura në Republikën e Kosovës, dhe atë ka marrë për bazë praktikën e PZAP-it, e cila ka vendosur për rastet të ngjashme të fjalëve të përdorura gjatë fushatës zgjedhore nga ana e Subjektit Politik Lista Serbe, dhe atë vendimin Anr.120/2017 datë 08.06.2017, në të cilin vendim të PZAP-it, i është shqiptuar gjoba subjektit politik Lista Serbe për arsye se kandidatët e Subjektit Politik, gjatë spotit zgjedhor kanë përdorur fjalë *“Për ruajtjen e institucioneve të Serbisë në Kosovë ndërsa Kosova quhet Kosova dhe Metohi...”*, i cili vendim i PZAP-it, 120/2017 datë 08.06.2017, është vërtetuar me Aktgjykim të Gjykatës Supreme AA.nr.4/2017 datë 12.06.2017,.

Po ashtu PZAP-i, ka vendosur për rastet të ngjashme të fjalëve të përdorura gjatë fushatës zgjedhore nga ana e kandidatëve të Subjektit Politik Lista Serbe, edhe me vendimin Anr.252/2017 datë 22.10.2017, në të cilin vendim të PZAP-it, i është shqiptuar gjoba subjektit politik Lista Serbe për arsye se kandidatët e Subjektit Politik, gjatë postimit në rrjetin social

Facebook kanë publikuar video në të cilën video të publikuar thuhet se *“Vota për Listën Serbe është votë për Serbinë në Kosovë dhe Metohi...”*.

Njëherit paneli i PZAP-it, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi morri për bazë edhe vendimin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut Sanchez kundër Francës [DHM], kërkesa nr. 45581/15, Vendimi gjyqësor i datës 15 maj 2023, në të cilin vendim ndër të tjera thuhet se : *“Megjithatë, liria e debatit politik mund të kufizohet për të penalizuar apo edhe për të parandaluar të gjitha format e shprehjes që propagandojnë, inkurajojnë, nxisin ose justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerance...”*.

Në nenin 10 par.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndër të tjera thuhet se *“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes...”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës ndër të tjera thuhet se *“Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme ... për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve...”*.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 11, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe duke marrë për bazë edhe nenin 1.1, 1.2, dhe nenin 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.191/2025 datë 13.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.